

**VENDIM**  
**Nr. 1081, datë 24.12.2020**

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË  
NDËRSEKTORIALE “AGJENDA DIGJITALE E SHQIPËRISË”, 2020–2022**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e planit të veprimit të strategjisë ndërsektoriale “Agjenda Digjitale e Shqipërisë”, 2020–2022, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, ministrinë dhe institucionet qendrore, të përmendura në tekstin e planit të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR**  
**Erion Braçe**



Objektivi 6. Rritja e sigurisë në rrjetet e informacionit															
<b>Prioriteti Strategjik 3. Politika për krijimin e Infrastrukturas Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI)</b>															
<b>Objektivi 1. Bashkërendimi ndërinstitucional për mbledhjen, përparimin dhe përditësimin i të dhënave gjeohapësinore si IMPUT për NSDI-n</b>															
Analiza e gjeoinformacionit dhe marrja e vendimeve për përgatitjen e Standardeve në përshatje me direktivën INSPIRE, si dhe sipas nevojës së Institutit.		ASIG			2015	2020	5,000,000	ALL							
Krijimi i grupeve të punës të përbashkëta për përditësimin e informacionit sipas tematikave.		ASIG			2015	2020	Pa kosto								
<b>Objektivi 2. Krijimi i një rrjeti unifikues gjeodezik për informacionin hartografik shtetëror duke përdorur rrjetin gjeodezik kombëtar shtetëror</b>															
Proiektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e përditësimi i Kordinatës Referuese Gjeodezike.		ASIG			2015	2020	17,500,000	ALL							
<b>Objektivi 3. Krijimi i një Sistemi të integruar gjeoinformacioni në Shtetëri sipas direktivës INSPIRE dhe përdorimi nga institucionet shtetërore dhe publiku i gjere.</b>															
Rritja e ndërgjegjësimit publik për përfitimet nga gjeoinformacioni, koordinimi për zhvillimin profesional dhe mundësitë e trajnimit për ngritjen e kapaciteteve të autoriteteve përkatëse për të rritur përdorimin e teknologjisë gjeohapësinore në një mënyrë sa më efektive, në bashkëpunim me sektorin akademik dhe privat.		ASIG				2022	5,000,000	ALL					Donator		
<b>Objektivi 4. Ndërtimi i Sistemit Kombëtar Gjeografik të Informacionit.</b>															
Ngritja e GIS-it Kombëtar në përputhje me standardet dhe rregullat e INSPIRE dhe OGC për të dhëna shërbimet mbi informacionin gjeohapësinor sipas tematikave.		ASIG			2020	2022	70,000,000	ALL				Buxheti i shtetit			
Ndërtimi i një platforme për të dhëna shërbimet gjeohapësinore, sipas standardeve të formatit <i>Datacube</i> , standardeve mbi shërbimet e rrjeti dhe dokumentit mbi shërbimet e rrjetit që do të përdoren në GIS kombëtar nga përdoruesit e gjere.		ASIG			2015	2020	50,000,000	ALL							
Bashkëpunim i ngushtë me qendrat e kërkim-zhvillimit kombëtar dhe ndërkombëtar, për të maksimizuar shkëmbimin e gjeoinformacionit midis autoriteteve shtetërore dhe për të përmirësuar teknologjinë e gjeoinformacionit.		ASIG			2015	2020	7,000,000	ALL					Donator		